



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**Anr . 278/2017**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Ymer Hoxha dhe Adnan Konushevci anëtarë si dhe me pjesëmarrje e zyrtarit të lart ligjor Kudret Hasani, duke vendosur lidhur me ankesën e BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA, me seli në Prishtinë, paraqitur ndaj Koalicioni PDK-AAK-NISMA, për shkak të vendosjes së posterave në afërsi të Qendrave të Votimit (QV) gjatë ditës së votimit, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 13.06.2017, mori këtë:

**V E N D I M**

**Refuzohet si e pabazuar** ankesa Anr 278/2017 e datës 12.06.2017 e parashtruar nga BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA

**A r s y e t i m**

Parashtruesi i ankesës, BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA, me seli në Prishtinë, me datën 12.06.2017, ka parashtruar ankesë në PZAP, me të cilën pretendohet se Koalicioni PDK-AAK-NISMA ka vendosur poster në afërsi të vendvotimit 1109b duke e shkelur neni 36 të Ligjit për Zgjedhje.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të bazueshmerisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore si dhe provave materiale-fotografisë së bashkangjitur, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 par.2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

**Ankesa është e pabazuar**

Parashtruesi i ankesës, me ankesën e tij pretendon se me datën 12.06.2017, Koalicioni PDK-AAK-NISMA ka vendosur poster në afërsi të vendvotimit 1109b.

Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve në ankesë nuk ka ofruar dëshmitë të qarta dhe bindëse për të vërtetuar pretendimet ankimore edhe pse barra e te provuarit bie mbi parashtruesin e ankesës, në kuptim të nenit 117 par.3 të LZP-së, për te provuar shkelësi i supozuar. Sepse nga fotoja e ofruar nuk mund të identifikohet në mënyrë bindëse dhe të qartë se vendi se ku gjendet Vendvotimi VV me numër 1109b.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
Anr 278/2017 më datën 13.06.2017

**Kryesuesi i Panelit**  
**Fejzullah Rexhepi**



**Këshillë juridike:** *Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur, mund të paraqet ankesë brenda afatit prej njëzet e katër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi në Gjykatën Supreme.*